

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Dr. Ing. H.c. F. Porshe Akciegezelshaft, Gjermani do të fitojë kontroll të pavarur mbi biznesin dhe mjetet që përbëjnë biznesin si një tregtar i autorizuar i automjeteve motorike i operuar nga Xhardin Specialist Kars Ltd., Mbretëria e Bashkuar**

**(lënda nr. 08-98/2024)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 25.06. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, i cili i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft me seli të regjistruar në Porsheplac 1, 70435 Shtuttgart, Gjermani që nëpërmjet shoqërisë së saj të varur në pronësi të plotë, Porshe Kars Grejt Britan Ltd. me seli të regjistruar në Bat Roud, Kalkot, Riading, Brks, RG31, 7SE, Mbretëria e Bashkuar synon të blejë biznesin dhe mjetet që përbëjnë biznesin si një tregtar i autorizuar i automjeteve të menaxhuar nga Xhardin Specialist Kars Ltd. me seli të regjistruar në 2 Loksl Haus Oukvud Kort, Litl Ouk Drajv, Ansl, Notingham, Angli, Anglia, i njohur si Porshe Center Londra Lindore dhe Porshe Center Londra Jugore.

**Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft** është një prodhues gjerman i automobilave dhe pjesë e Grupit Folksvagen ("Grupi Folksvagen"), i specializuar në makina sportive, SUV dhe sedan me performancë të lartë.

Grupi Folksvagen është aktiv në mbarë botën në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e makinave të udhëtarëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve të transportit, shasive të autobusëve dhe motorëve me naftë motoçikletave, duke përfshirë edhe pjesë rezervë dhe pajisje shtesë. Grupi Folksvagen është gjithashtu i angazhuar në shpërndarjen e automjeteve. Grupi Folksvagen përfshin markat e automjeteve Folksvagen Pesinxher Kars, Folksvagen Lajt Komrshal, Porshe, Audi, Shkoda, Bently, Lamborgini, SEAT, MAN, Skania dhe Dukati. Grupi Folksvagen ofron gjithashtu shërbime të lëvizshmërisë, të tilla si automjetet në thirrje dhe ndarjen e automjeteve.

Grupi Folksvagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura si më poshtë:

- Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me aktivitet bazë të regjistruar – lizing financiar;

-Porshe Broker SHA Skopje, me seli të regjistruar në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Skopje dhe me aktivitet bazë të regjistruar- veprimtaritë e përfaqësuesve të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit;

- Skania Makedonia SHPKNJP Ilinden, me seli në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe me aktivitet bazë të regjistruar- - tregti me mjete të tjera motorike dhe

- Porshe Makedonia SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me aktivitet bazë të regjistruar- tregti të makinave dhe mjeteve motorike të kategorisë së lehtë.

Biznesi i synuar përbëhet nga operacionet e biznesit dhe mjetet e PC Londra e Jugut, e cila filloi operimet në janar 2018, dhe PC Londra Lindore, e cila nga ana tjetër filloi operimet në prill 2015. Biznesi i synuar aktualisht është në pronësi dhe i operuar nga XhSK. PC Londra e Jugut dhe PC Londra Lindore janë aktualisht përfaqësues të pavarur të Porshe që operojnë në tre fushat e mëposhtme të biznesit:

- Shpërndarja me pakicë dhe shitja e të gjitha llojeve të makinave Porshe të reja dhe të përdorura (automjete sportive dhe të terrenit);

- Ofrimi i shërbimeve të lehta të riparimit dhe mirëmbajtjes për të gjitha llojet e makinave Porsche dhe
- Shpërndarja me pakicë e pjesëve rezervë origjinale Porsche, veçanërisht për makinat e linjës Porsche Klasik (Porsche Classic). Porsche Klasik i referohet automjeteve retro që nuk janë prodhuar rregullisht për të paktën 10 vjet.

Biznesi i synuar nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Tregjet relevante të mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohen si:

- tregu për shpërndarjen me pakicë të makinave të reja dhe të përdorura të pasagjerëve;
- Tregu i shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së Makinave; dhe
- tregu për shitjen e pjesëve rezervë origjinale për makinat Porsche.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

01.07.2024

Shkup